



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

Raporti vjetor për konsultimet publike në Qeverinë e Republikës së Kosovës për vitin 2024



Mars 2025

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Përmbledhje Ekzekutive
3. Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve
4. Tabela 5: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve në nivel lokal - Konsultat që janë mbyllur gjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2024
5. Përmirësimi dhe avancimi i procesit të konsultimeve me publikun, ngritja e kapacitetit të zyrtarëve dhe procesi i bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile
6. Ministrinë që i kanë plotësuar standardet plotësisht janë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal
7. Numri i përgjithshëm dhe statusi i komenteve të projekt dokumentet
8. Përmbledhje për procesin e konsultimeve gjatë vitit 2024
9. Rekomandimet e nxjerra

SHTOJCA I: Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve (Lista e dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2024)

SHTOJCA II: Lista e dokumenteve të publikuara sipas regjistrimit të platformës prej 01.01.2024-31.12.2024

Lista e Tabelave

- Tabela 1: Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat e hapura gjatë periudhës- Data:01.01.2024-31.12.2024.
- Tabela 2: Numri i dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2024 për të cilat konsultimi është mbyllur-data 01.01.2024-31.12.2024 .
- Tabela3: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale Data: 01.01.2024-31.12.2024.
- Tabela4:Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve .
- Tabela 5: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve në nivel lokal - Konsultat që janë mbyllur gjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2024
- Tabela 6: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale - Data: 01.01.2024-31.12.2024

Lista e Figurave

- Figura 1.Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat gjatë periudhës - Data: 01.01.2024 - 31.12.2024
- Figura 2: Shkalla e plotësimit të standardeve minimale për dokumentet e publikuara sipas institucioneve për vitin 2024
- Figura 3: Shkalla e plotësimit të standardeve minimale për dokumentet e publikuara sipas institucioneve për vitin 2024

Lista e shkurtesave

- | | |
|-----------|---|
| 1. ZKM | Zyra e Kryeministrit |
| 2. ZQM | Zyra për Qeverisje të Mirë |
| 3. MAPL | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal |
| 4. MASHT | Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë |
| 5. MBPZHR | Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| 6. MD | Ministria e Drejtësisë |
| 7. MFPT | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve |
| 8. MM | Ministria e Mbrojtjes |
| 9. MINT | Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë |
| 10. MKRS | Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve |
| 11. MPB | Ministria e Punëve të Brendshme |
| 12. MPJD | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës |
| 13. MSH | Ministria e Shëndetësisë |
| 14. MMPHI | Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës |
| 15. ME | Ministria e Ekonomisë |
| 16. MZHR | Ministria e Zhvillimit Rajonal |
| 17. MKK | Ministria për Kthimit dhe Komuniteteve |
| 18. KE | Komisioni Evropian |

Të nderuar/a,

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, gjatë vitit 2024 ka vazhduar të forcojë procesin e konsultimeve publike si një mjet kyç për përfshirjen e qytetarëve, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë relevantë në hartimin dhe zbatimin e politikave publike. Kjo praktikë ka kontribuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe cilësisë së vendimmarrjes institucionale.

Viti 2024 ka shënuar progres të rëndësishëm, përfshirë rritjen e pjesëmarrjes publike, zhvillimin dhe avancimin e platformës digjitale për konsultime me publikun <https://konsultimet.rks-gov.net/> dhe ngritjen e kapaciteteve të administratës publike për zbatimin më efektiv të konsultimeve. Kjo është realizuar veçanërisht përmes përdorimit të platformës për konsultime me publikun.

Në këtë raport prezantojmë një pasqyrë të sukseseve, sfidave dhe rekomandimeve konkrete për përmirësimin e mëtejshëm të procesit të konsultimeve publike. Një ndër prioritetet për të ardhmen është zgjerimi dhe krijimi i qëndrueshmërisë së këtij procesi edhe në nivelin lokal, duke e bërë pjesëmarrjen qytetare më të gjerë, më të barabartë dhe më përfaqësuese. Megjithatë, janë identifikuar edhe sfida të vazhdueshme, si mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme në disa institucione, mos angazhimi i duhur i grupeve të ndryshme të interesit dhe nevoja për një qasje më të standardizuar dhe të qëndrueshme në të gjitha nivelet.

Qëllimi ynë mbetet i pandryshuar dhe i pandalshëm, të ndërtojmë një kulturë të qëndrueshme të dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Me respekt,
Habit Hajredini

1. Hyrje

Viti 2024 shënoi një progres të rëndësishëm në konsolidimin e praktikave të konsultimit publik në Republikën e Kosovës, veçanërisht në drejtim të përfshirjes aktive të organizatave të shoqërisë civile (OSHC). Me mbështetjen e Platformës për Konsultime me Publikun (<https://konsultimet.rks-gov.net>), është arritur një nivel më i lartë transparence në hartimin, publikimin dhe raportimin e politikave dhe legjislacionit, duke mundësuar përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe publikut të gjerë në këto procese.

Ky zhvillim reflekton përkushtimin në rritje të institucioneve publike për të zbatuar standardet demokratike dhe për të siguruar llogaridhënie në hartimin e politikave. Angazhimi i organizatave joqeveritare dhe interesimi i tyre për të qenë pjesë aktive e procesit, si dhe raportimi më i qartë nga ana e institucioneve, janë tregues të një dinamike pozitive dhe progresive.

Platforma për Konsultimet Publike tashmë është një mjet institucional dhe zyrtar i domosdoshëm, që shërben si pikë qendrore e komunikimit ndërmjet institucioneve publike, palëve të interesuara dhe qytetarëve. Ajo siguron pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e politik bërjes dhe vendimmarrjes me interes publik, duke rritur transparencën dhe përgjegjësinë e organeve publike.

Pjesëmarrja aktive e shoqërisë civile është bërë gjithnjë e më e dukshme përmes kësaj platforme online, ku palët e interesuara janë regjistruar dhe kanë kontribuar përmes komenteve dhe pjesëmarrjes në hartimin e politikave dhe legjislacionit.

Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë (ZQM) në Zyrën e Kryeministrit, ka shënuar progres në zhvillimin e standardeve dhe praktikave për rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e politikë bërjes. Një hap i rëndësishëm ka qenë integrimi i Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimeve Publike (Nr. 05/2016) në Rregulloren e re të Qeverisë (Nr. 17/2024 për Rregulloren dhe Procedurën e Qeverisë së Republikës së Kosovës).

Zyra për Qeverisje të Mirë, si koordinatore e procesit të konsultimeve publike, vazhdon të jetë përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha konsultimeve, përfshirë ato përmes platformës online. Aktualisht, kjo zyrë është në proces të inicimit dhe hartimit të një manuali të ri për zbatimin e Rregullores së re, ndërkohë që po vazhdohet të zbatohet manuali ekzistues deri në finalizimin e të riut.

Në përputhje me Rregulloren e re të Punës së Qeverisë (Nr. 21.05.2024), Zyra për Qeverisje të Mirë, në bashkëpunim me koordinatorët për konsultime nga të gjitha ministritë dhe institucionet përkatëse, ka përgatitur edhe raportin vjetor të konsultimeve publike për vitin 2024.

Sipas statistikave të publikuara për periudhën raportuese, gjatë vitit 2024 janë publikuar gjithsej 259 dokumente në Platformën për Konsultime Publike, të cilat përfshijnë:

- 20 koncept dokumente
- 37 projektligje
- 10 strategji
- 03 programe
- 09 plane veprimi
- 60 draft-rregullore
- 114 udhëzime administrative dhe
- 06 dokumente të tjera.

Ky progres tregon për një angazhim të vazhdueshëm institucional për të forcuar dialogun me publikun dhe për të garantuar një proces më transparent dhe gjithëpërfshirës të politik bërjes në Republikën e Kosovës.

2. Përmbledhje Ekzekutive

Raporti për konsultimet me publikun për vitin 2024 përmbledh procesin dhe rezultatet e konsultimeve publike të zhvilluara nga institucionet përkatëse gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2024. Ky raport përfshin dokumentet e publikuara në platformën zyrtare të konsultimeve (<https://konsultimet.rks.gov.net>) dhe analizon nivelin e pjesëmarrjes së publikut dhe ndikimin e komenteve të marra te këto dokumente.

Pikat kryesore të raportit janë të përmbledhura në:

- Dokumentet e konsultuara, pra lista e dokumenteve të publikuara duke përfshirë titullin/llojin e secilit dokument.
- Periudha e konsultimeve me kohëzgjatjen e secilit proces konsultimi dhe përfshirja e palëve të interesit.
- Pjesëmarrja e publikut, pra numri i komenteve të pranuar dhe analiza e kontributit të dhënë nga qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Rezultatet e konsultimeve ku pasqyrohen dokumentet e miratuara pas shqyrtimit të komenteve dhe regjistri për secilin dokument të konsultuar si dhe
- Rekomandime dhe mësim të nxjerra: për sugjerimet dhe përmirësimin e procesit të konsultimeve për të ardhmen.

Angazhimi i organizatave të shoqërisë civile me rreth 52 dokumente dhe 170 komente të dorëzuara nga OSHC, raporti tregon një pjesëmarrje solide, por që ende mbetet selektive dhe jo përfaqësuese për të gjithë sektorin civil. Angazhimi i tyre në jo shumë projekt-dokumente tregon interesim për temat që prekin drejtpërdrejt interesin publik, por gjithashtu nënvizon nevojën për përfshirje më të gjerë të tyre në politik bërje.

Sa i përket cilësisë dhe relevancës së komenteve gjithashtu komentet e dorëzuara nga OSHC-të kanë pasur natyrë konstruktive, shpesh të detajuara dhe të fokusuara në përmirësimin e cilësisë së politikave. Komentet kanë pasur më së shumti ndikim në dokumentet ku temat kanë qenë të ndjeshme dhe të prekshme për publikun. Megjithatë, një pjesë e tyre nuk është reflektuar në versionin final të dokumenteve, duke ngritur vetëdijen dhe pikëpyetjen mbi atë se si ti trajtojmë dhe qasemi ndikimit real të konsultimeve dhe komenteve të publikut në politika dhe legjislacion.

Një zhvillim pozitiv është raportimi më i qartë nga institucionet për trajtimin dhe pranimin e komenteve, me shembuj të dokumentuar të reflektimeve në disa raste. Kjo ndihmon në ndërtimin e besimit ndërmjet palëve dhe rrit llogaridhënien e autoriteteve publike.

Raporti paraqet një vlerësim të përgjithshëm të transparencës dhe përfshirjes së publikut në vendimmarrje, duke nënvizuar praktikën më të mira dhe sfidat e hasura gjatë vitit.

Gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2024, janë publikuar gjithsej 251 dokumente (konsulta të mbyllura) nga institucionet qeveritare.

Institucionet me përqindjen më të lartë të dokumenteve me raport final janë:

- Ministria e Mbrojtjes - 100.00%
- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - 100.00%
- Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit - 100.00%
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - 100.00%
- Ministria e Zhvillimit Rajonal - 100.00%
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - 80.00%
- Ministria e Ekonomisë - 75.00%
- Zyra e Kryeministrit - 64.71%
- Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - 62.86%
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - 54.29%
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - 50.00%
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - 50.00%
- Ministria e Drejtësisë - 42.42%
- Ministria e Punëve të Brendshme - 30.23%
- Ministria e Shëndetësisë - 0.00%.

Ky rezultat tregon një ndarje pothuajse të barabartë të dokumenteve të publikuara me dhe pa raporte finale për vitin 2024, mirëpo me disa institucione që kanë përformuar dukshëm më mirë në përgatitjen e raporteve përfundimtare se sa të tjerat. Nga 251 dokumente me konsultim të mbyllur, prej tyre me raporte finale janë (144 dokumente ose 57.37 %) ndërsa pa raporte finale janë (107 dokumente ose 42.63%).

Nga këto dokumente, pra prej 259, janë 52 dokumente që kanë përfshirë komente dhe kontribut nga bashkëpunëtorët (170 komente ose 20.08%), ndërsa janë 207 dokumente (79.92%) që janë publikuar pa komente të bashkëpunëtorëve.

Te platforma për konsultime janë publikuar me dhe pa komente të bashkëpunëtorëve dokumentet te ministrinë:

- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës kanë përqindjen të lartë të dokumenteve me komente nga bashkëpunëtorët (100%).
- Ministria e Ekonomisë ka gjithashtu një përqindje të lartë (50%) krahasuar me institucionet e tjera.
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve nga gjithsej 15 dokumente, 6 prej tyre janë me komente dhe 9 pa komente, ose 40.00%
- Ministria e Drejtësisë ka numrin më të lartë të dokumenteve me komente (10 dokumente), duke shënuar një përqindje prej 28.57%.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga gjithsej 22 dokumente, 5 prej tyre janë me komente dhe 17 pa komente, ose 22.73%.
- Në përgjithësi, numri më i madh i dokumenteve është publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (44 dokumente), ku vetëm 18.18% kanë përfshirë kontribut nga bashkëpunëtorët dhe
- Institucionet si Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe disa ministri të tjera nuk kanë përfshirë komente nga bashkëpunëtorët në asnjë dokument të publikuar (0%).
- Llojet më të shpeshta të dokumenteve kanë qenë udhëzimet administrative (45.52%) dhe draft rregulloret (22.39%).

Institucionet më aktive, pra sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve te platforma kanë qenë:

- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me 07 dokumente (100%),
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me 02 dokumente (100%),
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me 25 dokumente ose 40.00%.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga gjithsej me 22 dokumente ose 22.73%.
- Ministria e Punëve të Brendshme me 44 dokumente (16.42% të totalit),
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me 38 dokumente (14.18%),
- Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me nga 35 dokumente secila (13.06%).

Ndërkohë, Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës nuk kanë publikuar asnjë dokument gjatë kësaj periudhe në platformë.

Në përgjithësi, dokumentet janë përqendruar në çështjet administrative dhe rregullave ku:

- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ku edhe kanë arritur përqindjen më të lartë të dokumenteve me komente nga bashkëpunëtorët (100%).
- Ministria e Ekonomisë ka gjithashtu një përqindje të lartë (50%) krahasuar me institucionet e tjera.
- Ministria e Drejtësisë gjithashtu ka numrin të lartë të dokumenteve me komente (10 dokumente), duke shënuar rritje në një përqindje prej 28.57%.
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me 25 dokumente ose 40.00%.
- Në përgjithësi, numri më i madh i dokumenteve është publikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme (44 dokumente), por vetëm 18.18% kanë përfshirë kontribut nga bashkëpunëtorët ndërsa institucionet si Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Mbrojtjes,

Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe disa ministri të tjera nuk kanë marrë komente nga bashkëpunëtorët në asnjë dokument të publikuar (0%).

Pjesëmarrja e bashkëpunëtorëve në komentimin dhe përfshirjen e hartimit të dokumenteve mbetet e ulët në shumicën e institucioneve, me vetëm rreth një të pestën e dokumenteve të publikuara që kanë përfshirë kontribut aktiv nga ta. Kjo tregon për nevojën e përmirësimit të proceseve të brendshme të bashkëpunimit dhe angazhimit më të madh të bashkëpunëtorëve në zhvillimin dhe hartimin e dokumenteve zyrtare.

Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Qendrën për Avokim për Kulturë Demokratike (ACDC), për gjithë përfshirje dhe mos diskriminim të komunitetit jo shumicë në vendimmarrje dhe politikë bërje, ka organizuar sesione informuese në Komunën e Graçanicës dhe Mitrovicën e Veriut për promovimin e Platformës së Konsultimeve Publike <https://konsultimet.rks-gov.net/>. Platforma për konsultime është një mjet digjital i cili u jep mundësi dhe fuqizon qytetarët për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje dhe hartim të politikave publike.

Këto aktivitete ishin të fokusuara posaçërisht në përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë me qëllim të:

- Rritjes së ndërgjegjësimit për rëndësinë e konsultimeve publike, mos diskriminimin dhe përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë në këtë proces;
- Nxitjes së përdorimit të platformës nga komunitetet jo shumicë në mënyrë që të mos mbeten të përjashtuara nga proceset politik bërëse dhe vendimmarrëse;
- Sigurimit të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- Promovimit të pjesëmarrjes së grupeve të cënueshme dhe komuniteteve jo shumicë në hartimin e legjislacionit dhe politikave publike.

Takimet mbledhën përfaqësues të shoqërisë civile nga komunitetet jo shumicë, aktivistë lokal dhe përfaqësues institucional, duke ofruar një hapësirë për diskutim, gjithë përfshirje e shkëmbim përvojash. Këto aktivitete po zhvillohen në kuadër të projektit “Mbështetje për institucionet dhe komunitetet për të ndërtuar një shoqëri të hapur dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë”, i cili projekt mbështetet nga Ambasada Britanike dhe Ambasada e Zvicrës në Kosovë, dhe po zbatohet nga Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM).

Gjithashtu, ka pasur arritje dhe progres në realizimin e qëllimeve të Zyrës për Qeverisje të Mirë/ Zyrës së Kryeministrit për mos diskriminim të personave me aftësi të kufizuara në përfshirje për përdorim të platformës për konsultime me publikun për këtë kategori. Është përmirësuar dhe zgjeruar spektri i komponentëve të sistemit të konsultimit në nivel të qeverisjes vendore dhe po ofrohet akses në platformën për konsultime për personat me aftësi të kufizuara.

Sfidat kryesore që janë evidentuar dhe janë nxjerrë nga ekipi i koordinatorëve të konsultimeve, OJQ-ve dhe partnerëve në proces janë:

- Përfshirja e gjerë e OSHC-ve jashtë rrjeteve të konsoliduar mbetet e kufizuar.
- Koha e shkurtër për konsultime në disa raste ka penguar përgatitjen e komenteve cilësore.
- Raportimi sipas rregullores dhe standardi në nivel të lartë nga ana institucionale për komentet që janë dhënë nga OJQ-të të dokumente e publikuara mbetet për tu përmirësuar.
- Mungesa e përgjigjeve të detajuara për komentet e refuzuara është një tjetër pikë që kërkon përmirësim.

Metodologjia e raportimit dhe monitorimit të zbatimit të standardeve

Raportimi vjetor për konsultimet me publikun është bërë sipas metodologjisë së raportimit për rregulloren për konsultimet me publikun. Për përgatitjen e raportit janë përdorur disa burime të informacionit

- Të dhëna e përcjella nga koordinatorët e konsultimeve publike nga secila ministri dhe Zyra e Kryeministrit.
- Të dhënat e publikuara dhe të përditësuara nga platforma për konsultimet me publikun dhe
- Të dhëna të tjera që rrjedhin nga aktivitetet e Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyrës së Kryeministrit dhe projektet që mbështesin Qeverinë në zhvillimin dhe avancimin e konsultimeve publike.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit në kërkesën për raportim nga ana e ministrive i janë përgjigjur 14 ministri nga 15 që janë, si dhe zyrat përgjegjëse në Zyrën e Kryeministrit.

Edhe këtë vit disa nga informatat e raportuara nga ministritë nuk janë përputhur me ato që gjenden në platformë, atëherë informacionet plotësuese janë marrë nga koordinatorët për konsultimet publike në ZKM dhe ministritë e linjës. Nga Platforma elektronike e konsultimeve publike gjatë vitit 2024 janë publikuar 259 dokumente ku konsultimi ka qenë i hapur edhe në vitin 2025 ndërsa për 251 prej tyre konsultimi është mbyllur më 31.12.2024.

Më poshtë kemi të pasqyruar të dhënat për rrjedhën e procesit të konsultimeve, numrin e dokumenteve të publikuara, komentet e dhëna nga publiku dhe OJQ-të, raportet dhe të dhëna tjera te platforma për konsultime me publikun.

[illegible]

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e hapura gjate periudhës (që janë hapur gjate periudhës)
- Data: 01.01.2024-31.12.2024

Institucioni / Tipi dokumentit	Koncept dokument	Draft ligj	Plan i veprimit	Draft rregullore	Udhëzim administrativ	Strategji	Program	Tjetër	Totali	Ne përqindje ne raport me te gjitha IRK-te
Ministria e Mbrojtjes	0	2	0	0	3	1	0	1	7	2.70%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	4	0	3	0	1	3	3	1	15	5.79%
Ministria e Shëndetësisë	5	0	0	1	2	3	4	0	15	5.79%
Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	0	30	0	4	0	0	0	1	35	13.51%
Ministria e Ekonomisë	0	1	0	0	0	0	1	2	4	1.54%
Ministria e Drejtësisë	8	0	12	0	2	1	1	11	35	13.51%
Ministria për Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Ministria e Punëve të Brendshme	14	6	0	17	2	2	2	1	44	16.99%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	0	0	0	0	6	0	1	0	7	2.70%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	0	1	1	0	0	0	0	0	2	0.77%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	0	0	4	0	1	0	0	5	1.93%
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Totali	20	37	9	60	114	10	3	6	259	
Ne përqindje	7.72%	14.29%	3.47%	23.17%	44.02%	3.86%	1.16%	2.32%		

Tabela 1: Përmbledhja e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e hapura gjate periudhës: 01.01.2024-31.12.2024

Ndërsa nga 259 dokumente ku konsultimi ka qenë i hapur edhe në vitin 2025, për 251 prej tyre konsultimi është mbyllur më 31.12.2024.

Permbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjatë periudhës (që janë mbyllur gjatë periudhës) - Data: 01.01.2024-31.12.2024										
Institucioni / Tipi dokumentit	Koncept dokument	Draft ligj	Plan i veprimit	Draft rregullore	Udhëzim administrativ	Strategji	Program	Tjetër	Totali	Ne përqin dje ne raport me të gjitha IRK-te
Zyra e Kryeministrit	2	7	1	3	2	2	0	0	17	6.77%
Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit	0	1	13	2	0	4	0	0	20	7.97%
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura	1	1	2	1	6	0	22	2	35	13.94 %
Ministria e Industrisë, Ndermarresise dhe Tregtise	4	1	0	0	1	0	9	0	15	5.98%
Ministria e Administritimit të Pushtetit Lokal	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0.40%
Ministria e Mbrojtjes	0	2	0	0	3	1	0	1	7	2.79%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	4	0	3	0	1	2	3	1	14	5.58%
Ministria e Shëndetësisë	3	0	0	1	2	3	4	0	13	5.18%
Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	0	31	0	3	0	0	0	1	35	13.94 %
Ministria e Ekonomisë	0	1	0	0	0	0	1	2	4	1.59%
Ministria e Drejtësisë	8	0	12	0	2	1	1	9	33	13.15%
Ministria për Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Ministria e Puneve të Brendshme	14	5	0	17	2	2	2	1	43	17.13%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	0	0	0	0	6	0	1	0	7	2.79%
Ministria e Puneve të Jashtme dhe Diaspores	0	1	1	0	0	0	0	0	2	0.80%

Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	0	0	4	0	1	0	0	5	1.99%
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Totali	18	35	6	58	113	10	5	6	251	
Ne përqindje	7.17%	13.94%	2.39%	23.11%	45.02%	3.98%	1.99%	2.39%		

Tabela 2. Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve-Konsultat që janë mbyllur gjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2024




Figura 1. Përmbledhje e llojit të dokumenteve për konsultat gjatë periudhës - Data: 01.01.2024 - 31.12.2024

Për të përmbledhur llojet e dokumenteve që janë publikuar me raporte finale, pra që i kanë përmbyllur të gjitha kriteret e konsultimit publik, atëherë ky rezultat si u tha edhe më lartë tregon një ndarje pothuajse të barabartë të dokumenteve të publikuara me dhe pa raporte finale për vitin 2024, mirëpo me disa institucione që kanë përmbyllur procesin dukshëm më mirë në përgatitjen e raporteve përfundimtare se të tjerat, duke veçuar MM, MASHT, MKRS, MAPL, MZHR, etj. Nga 251 dokumentet e publikuara te platforma për të cilat konsultimi është mbyllur në 2024, prej tyre me raporte finale janë (144 dokumente ose 57.37%) ndërsa pa raporte finale janë (107 dokumente ose 42.63%). Pra, këtë vit krahasuar me vitet paraprake kemi përqindje pak më të ulët të zbatimit të rregullave për konsultime publik.

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale - Data: 01.01.2024-31.12.2024				
Institucioni	Me raport final	Pa raport final	Totali	Ne përqindje ne raportin (Me raport / Pa raport)
Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	24	11	35	68.57%
Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	20	0	20	100.00%
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	19	16	35	54.29%
Ministria e Drejtësisë	14	19	33	42.42%
Ministria e Punëve të Brendshme	13	30	43	30.23%
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	12	3	15	80.00%
Zyra e Kryeministrit	11	6	17	64.71%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	7	7	14	50.00%
Ministria e Mbrojtjes	7	0	7	100.00%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	7	0	7	100.00%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	5	0	5	100.00%
Ministria e Ekonomisë	3	1	4	75.00%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1	0	1	100.00%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	1	1	2	50.00%
Ministria për Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0.00%
Ministria e Shëndetësisë	0	13	13	0.00%
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	0	0	0	0.00%
Totali	144	107	251	
Ne përqindje	57.37%	42.63%		

Tabela 3. Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale nga data 01.01.2024-31.12.2024

Permbledhje e llojeve te dokumenteve te publikuara sipas institucioneve - Konsultat e hapura gjate periudhes (qe jane hapur gjate periudhes) - Data: 01.01.2024-31.12.2024




Figura 2.Përmbledhje e llojit të dokumenteve sipas publikimit të raporteve finale për institucione gjatë periudhës - Data: 01.01.2024 - 31.12.2024

Pjesëmarrja dhe kontributi i bashkëpunëtorëve pasqyrohen në tabelën e radhës ku përmbledhen llojet e dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve dhe angazhimi i organizatave të shoqërisë civile me rreth 52 pjesëmarrëse dhe 170 komente të dorëzuara nga OSHC, tregon një pjesëmarrje të madhe, e cila jep edhe shumë hapësirë për përmirësim për të gjithë sektorin e shoqërisë civile.

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve - Array 01.01.2024-31.12.2024				
Institucioni	Me komente (kontribute nga bashkëpunëtorët)	Pa komente (kontribute nga bashkëpunëtorët)	Totali	Ne përqindje ne raportin (Me komente / Pa komente)
Zyra e Kryeministrit	3	10	13	23.08%
Ministria e Kulturës Rinise dhe Sportit	5	17	22	22.73%
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	4	34	38	10.53%
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	1	15	16	6.25%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	0	1	1	0.00%
Ministria e Mbrojtjes	0	7	7	0.00%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	6	9	15	40.00%
Ministria e Shëndetësisë	3	12	15	20.00%
Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1	34	35	2.86%
Ministria e Ekonomisë	2	2	4	50.00%
Ministria e Drejtësisë	10	25	35	28.57%
Ministria për Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0.00%
Ministria e Punëve të Brendshme	8	36	44	18.18%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	7	0	7	100.00%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	2	0	2	100.00%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	0	5	5	0.00%
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	0	0	0	0.00%
Totali	52	207	259	
Ne përqindje	20.08%	79.92%		

Tabela 4. Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas aktivitetit të bashkëpunëtorëve nga data 01.01.2024-31.12.2024

Konsultimi publik në nivelin lokal në Republikën e Kosovës

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bashkë me MAPL, koordinаторët për konsultime dhe organizatat e shoqërisë civile kanë për qëllim të përmirësojë dukshëm transparencën e institucioneve publike për organizatat e shoqërisë civile dhe publikun e gjerë dhe të rrisin llogaridhënien e tyre. Pra, sistemi i konsultimeve publike është zgjeruar edhe në shumicën e komunave, jo vetëm në aspektin rregullator, por edhe në krijimin e mjeteve dhe kushteve për zbatim. Pothuaj se të gjitha komunat tashmë janë pjesë e integruar e platformës për konsultimet me publikun dhe shumica nga kryetarët e komunave kanë emëruar koordinatorë për konsultime me publikun dhe po publikojnë dokumente për konsultim për t'u konsultuar dhe përfshirë publiku dhe organizatat jo-qeveritare në politikë bërje.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit përmes sistemit ka krijuar hapësirë të platforma për secilën komunë dhe u ka ofruar përkrahje koordinatorëve për konsultime për pjesëmarrjen e publikut në procesin e konsultimit publik përmes platformës edhe nivelit lokal. Ky është një hap shumë progresiv dhe përparues për institucionet në sistemin e qeverisjes së mirë, përfshirjes së publikut në politik bërje dhe llogaridhënës për qytetarin.

Nga data 01.01.2024 deri më 31.12.2024, niveli lokal ka publikuar në total 193 dokumente, duke përfshirë 10 koncept dokumente, 03 draft ligj, 15 strategji, 01 programe, 40 plane veprimi, 36 draft rregullore, dhe 88 dokumente të tjera. Megjithatë, në këtë raport detajet statistikore për publikimin e dokumenteve dhe konsultimet publike në nivel lokal nuk janë të përfshira.

Vlen të theksohet se Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Glllogocit, Gjilanit, Ferizajt, Rahovecit, Suharekës, Kaçanikut, Skenderajt, Kamenicës, Hani i Elezit, Junikut, Podujevës, Mitrovicës, Istogut, Shtimes, e Vushtrrisë dhe shumë të tjera kanë publikuar dokumente për konsultime me publikun gjatë vitit 2024. Megjithatë, ka rreth dhjetë komuna që nuk kanë publikuar dokumente në platformë për konsultime me publikun.

Më poshtë është pasqyra e publikimit të dokumenteve të platforma nga niveli lokal.

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjatë periudhës (që janë mbyllur gjatë periudhës)
- Data: 01.01.2024-31.12.2024

Institucioni / Tipi dokumentit	Koncept dokument	Draft ligj	Plan i veprimit	Draft rregullore	Udhëzim administrativ	Strategji	Program	Tjetër	Totali	Ne përqindje ne raport me te gjitha IRK-te
Komuna Deçan	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0.52%
Komuna Dragash	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Ferizaj	0	0	0	0	0	0	0	11	11	5.70%
Komuna Fushë Kosovë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Gjakovë	1	0	2	1	0	0	0	0	4	2.07%
Komuna Gjilan	4	0	6	4	0	0	0	23	37	19.17%
Komuna Glllogoc	0	1	2	1	0	6	0	3	13	6.74%

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjatë periudhës (që janë mbyllur gjatë periudhës)
- Data: 01.01.2024-31.12.2024

Institucioni / Tipi dokumentit	Koncept dokument	Draft ligj	Plan i veprimit	Draft rregullore	Udhëzim administrativ	Strategji	Program	Tjetër	Totali	Ne përqindje ne raport me te gjitha IRK-te
Komuna Graçanicë	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0.52%
Komuna Hani i Elezit	0	0	0	3	0	0	0	3	6	3.11%
Komuna Istog	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Junik	3	0	0	0	0	1	0	0	4	2.07%
Komuna Kaçanik	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Kamenicë	0	0	2	2	0	0	0	1	5	2.59%
Komuna Klinë	0	0	1	3	0	1	0	4	9	4.66%
Komuna Klllokot	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Leposaviq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Lipjan	0	0	5	3	0	2	0	2	12	6.22%
Komuna Malishevë	0	0	2	2	0	0	0	4	8	4.15%
Komuna Mamushë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Mitrovicë	0	0	2	0	0	0	0	8	10	5.18%
Komuna Mitrovica Veriore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Novobërdë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Obiliq	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Partesh	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Pejë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Podujevë	0	0	2	0	0	0	0	4	6	3.11%
Komuna Prishtinë	2	0	1	1	0	0	0	6	10	5.18%

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve - Konsultat e mbyllura gjatë periudhës (që janë mbyllur gjatë periudhës)
- Data: 01.01.2024-31.12.2024

Institucioni / Tipi dokumentit	Koncept dokument	Draft ligj	Plan i veprimit	Draft rregullore	Udhëzim administrativ	Strategji	Program	Tjetër	Totali	Ne përqindje ne raport me te gjitha IRK-te
Komuna Prizren	0	0	3	6	0	2	0	9	20	10.36%
Komuna Rahovec	0	0	2	0	0	0	0	1	3	1.55%
Komuna Ranillug	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Shtërpçë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Shtime	0	0	3	5	0	2	0	0	10	5.18%
Komuna Skenderaj	0	0	2	1	0	1	1	2	7	3.63%
Komuna Suharekë	0	0	2	0	0	0	0	5	7	3.63%
Komuna Viti	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Vushtrri	0	2	3	4	0	0	0	0	9	4.66%
Komuna Zveçan	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Komuna Zubin Potok	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
Totali	10	3	40	36	0	15	1	88	193	
Ne përqindje ne raport me te gjitha IRK-te	5.18%	1.55%	20.73%	18.65%	0.00%	7.77%	0.52%	45.60%		

Tabela 5: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas institucioneve në nivel lokal - Konsultat që janë mbyllur gjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2024

Përmirësimi dhe avancimi i procesit të konsultimeve me publikun, ngritja e kapacitetit të zyrtarëve dhe procesi i bashkëpunimit të qeverisë me shoqërinë civile

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, për të përmirësuar dhe avancuar procesin e konsultimeve, ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët, qasjen dhe koordinimin ndërinstitucional për proces të konsultimit, përveç punës së vazhdueshme është duke zbatuar dhe zhvilluar një sërë politikash dhe rekomandimesh që kanë rezultuar nga analizat dhe vlerësimet përkatëse të këtij procesi. Një nga

dokumentet kyçe në këtë drejtim është “Korniza për përmirësimin e zbatimit të standardeve minimale për konsultimet me publikun për periudhën 2021–2025”, e cila është realizuar në bashkëpunim me OSBE-në. Aktualisht, po punohet në përmirësimin, zhvillimin dhe avancimin e funksionalitetit të përgjithshëm të Platformës Online për Konsultime me Publikun.

Në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve publikë për procesin e konsultimeve, janë organizuar trajnime të ndryshme në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP), ekipin e trajnerëve të certifikuar dhe ZQM/ZKM dhe ekspert të tjerë. Këto trajnime janë mbajtur si në formë të grupeve, ashtu edhe brenda vetë institucioneve përgjegjëse për konsultime publike.

Po ashtu, është duke u përmirësuar qasja në Platformën Online për personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar pjesëmarrje më të plotë dhe aktive të tyre në proceset shoqërore dhe në zhvillimin e politikave publike në Kosovë. Po përmirësohet

- Avancimi i përfshirjes së publikut dhe shoqërisë civile në konsultime po bëhet përmes qasjeve të strukturuar e të planifikuara mirë nga ana e institucioneve.
- Organizimi i trajnimeve të rregullta dhe të specializuara mbi pjesëmarrjen publike, teknikat e konsultimit dhe komunikimin me shoqërinë civile;
- Përdorimi e rasteve studimore dhe praktikave të mira nga vende të tjera;
- Hartimi i udhëzuesve praktikë, zhvillim i manualeve dhe protokolleve që udhëzojnë stafin për organizimin dhe menaxhimin efektiv të proceseve të konsultimeve;
- Përdorimi i metodologjive të ndryshme, si konsultimet online, takimet fizike, pyetësorët publikë, etj.
- Ekipet për ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira, si dhe shkëmbime të drejtpërdrejta zyrtare për të mësuar nga modelet e suksesshme.

Një element kyç është edhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile (OSHC), përmes ndërtimit të kapaciteteve të përbashkëta dhe hartimit të proceseve të përbashkëta të konsultimit, duke nxitur partneritete efektive dhe të qëndrueshme.

Shkalla e plotësimit të standardeve minimale për procesin e konsultimeve

Edhe këtë vit kualiteti i konsultimit, metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti dhe burimet e alokuara nuk e lejojnë vlerësimin e plotësimit të standardeve në aspektin kualitativ. Megjithatë, sipas informacioneve të ofruara përmes raportimit dhe atyre të publikuara, ka shumë shembuj të mirë të ministrive që kanë publikuar dhe konsultuar dokumente në platformë gjatë vitit 2024 sipas standardeve të rregullores dhe përtej kësaj kornize.

Ministritë që i kanë plotësuar standardet plotësisht janë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale - Data: 01.01.2024-31.12.2024				
Institucioni	Me raport final	Pa raport final	Totali	Ne përqindje ne raportin (Me raport / Pa raport)
Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	24	11	35	68.57%
Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	20	0	20	100.00%
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	19	16	35	54.29%
Ministria e Drejtësisë	14	19	33	42.42%
Ministria e Punëve të Brendshme	13	30	43	30.23%
Ministria e Industrisë, Ndermarresise dhe Tregtisë	12	3	15	80.00%
Zyra e Kryeministrit	11	6	17	64.71%
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	7	7	14	50.00%
Ministria e Mbrojtjes	7	0	7	100.00%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	7	0	7	100.00%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	5	0	5	100.00%
Ministria e Ekonomisë	3	1	4	75.00%
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1	0	1	100.00%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	1	1	2	50.00%
Ministria për Kthim dhe Komunitete	0	0	0	0.00%
Ministria e Shëndetësisë	0	13	13	0.00%
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës	0	0	0	0.00%
Totali	144	107	251	
Ne përqindje	57.37%	42.63%		

Tabela 6: Përmbledhje e llojeve të dokumenteve të publikuara sipas publikimit të raporteve finale - Data: 01.01.2024-31.12.2024




Figura 3: Shkalla e plotësimit të standardeve minimale për dokumentet e publikuara sipas institucioneve për vitin 2024

Numri i përgjithshëm dhe statusi i komenteve të projekt dokumentet

Gjatë vitit 2024, duke filluar nga 01.01.2024 -31.12. 2024 në platformën për konsultimet me publikun janë publikuar 259 dokumente, ku për 251 prej tyre konsultimi është mbyllur më 31.12.2024 dhe të tjerat konsultimi është mbyllur te 2025. Prej tyre janë: 29 koncept dokumente, 37 projektligje, 10 strategji, 03 programe, 09 plane veprimi, 60 draft-rregullore, 114 udhëzime administrative dhe 06 dokumente të tjera.

Sipas publikimit në platformë, raportohet se gjatë procesit të konsultimeve publike komente direkt u morën gjithsej 170 komente për rreth 53 dokumente. Shumica e dokumenteve të konsultuara në platformë janë gjithashtu konsultuar edhe përmes komunikimit zyrtar dhe takimeve të punës, përfshi ato online, ku komentet janë dhënë edhe me shkrim, dhe të tjera metoda komunikimi e konsultimi.

Shumica e komenteve në platformë janë ofruar përmes dokumenteve të bashkëngjitura, të cilat e përmbajnë një numër më të madh të komenteve se sa ato që gjenerohen automatikisht në seksionin e statistikave. Numri i komenteve të llogaritura në këtë raport bazohet në informacionet zyrtare të

ofruara nga koordinatorët e konsultimeve publike në ministrinë e caktuar. Është e rëndësishme të theksohet se pjesëmarrja e publikut në procesin e konsultimeve ndryshon nga ministria në ministri.

Përmbledhje për procesin e konsultimeve gjatë vitit 2024

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka për qëllim të përmirësojë hapjen dhe transparencën e institucioneve për publikun dhe të rrisë llogaridhënien e tyre. Kjo zyrë është e përkrahur nga koordinatorët për konsultimet me publikun në Zyrën e Kryeministrit, nga ministritë e linjës dhe tash edhe koordinatorët e nivelit lokal.

Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit, së bashku me ministritë dhe komunat, ka arritur të publikojë dhe të ndajë pothuajse të gjitha dokumentet që janë hartuar dhe janë aprovuar apo janë në procesin e aprovimit në qeveri, ministri e edhe nga kryetarët e komunave te platformën online <https://konsultimet.rks-gov.net/>. Kjo ka hapur rrugën për pjesëmarrje, informim dhe kontribut të publikut dhe organizatave jofitimprurëse në hartimin e politikave dhe legjislacionit të institucioneve publike. Bashkë me koordinatorët, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit ka punuar në ofrimin e hapësirës maksimale për pjesëmarrjen e publikut në procesin e konsultimit publik.

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, si koordinator e procesit të konsultimeve me publikun në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe koordinatorët për konsultime, ka punuar në monitorimin dhe zbatimin e standardeve për konsultimet me publikun. Në përputhje me Rregulloren e re të punës qeverisë, deri tash edhe Rregulloren nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Konsultimet me Publikun, Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit udhëheq dhe është përgjegjëse për hartimin e Raportit Vjetor për Konsultimet Publike të zhvilluara nga të gjitha ministritë dhe Zyra e Kryeministrit.

Në bashkëpunim me të gjitha ministritë dhe institucionet e përfshira në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit, zyra ka përgatitur raportet vjetore për konsultimet me publikun për vite me radhë. Raporti vjetor për vitin 2024 përmban të gjitha dokumentet që janë publikuar në platformën për konsultimet me publikun dhe për të cilat konsultimi ka filluar në datën 01.01.2024 dhe ka përfunduar më datën 31.12.2024.

Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë punën e bërë gjatë vitit 2024 në zbatimin e standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike nga qeveria dhe ministritë e linjës. Raporti i përmban detajet dhe statistikën për përmbushjen e standardeve, duke filluar nga planifikimi, iniciimi dhe procesi i hartimit të dokumenteve, deri te rrjedha e konsultimit, hartimi i dokumentit të konsultimit, përdorimi i metodave të konsultimit dhe veçanërisht i platformës, pjesëmarrja e publikut në ofrimin e kontributeve të tyre, si dhe statusi i komenteve, etj.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 Qeveria e Republikës së Kosovës e ka publikuar në konsultim 259 dokumente, 251 për të cilat konsultimi janë të mbyllura e finalizuar e të cilat hyjnë në kategorinë e dokumenteve që sipas Rregullores hartuesit e tyre e kanë për obligim t'i konsultojnë me publikun.

Rekomandimet e nxjerra

Angazhimi ynë është të kapërcejmë sfidat aktuale dhe të sigurojmë rrugë zgjidhje më të sigurte për bashkëpunim të qëndrueshëm ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile.

Zhvillimet dhe progresi në procesin e konsultimeve publike në vitet e fundit janë një përparim i vlerësuar shumë në përmirësimin e standardeve për politikën bërjen dhe hartimin e legjislacionit në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, gjithmonë hasim sfida gjatë këtij rrugëtimi, duke filluar nga sfidat teknike deri te mos përmbushja e obligimeve institucionale për zbatimin e tyre.

Synimi i Zyrës së Kryeministrit/Zyrës për Qeverisje të Mirë është dhe mbetet që të punojë bashkë me ministrinë, komunat dhe organizatat joqeveritare në përmirësimin e procesit të konsultimit publik, duke siguruar më shumë transparencë në vendimmarrjen dhe formulimin e politikave. Përfundimisht, me një angazhim të plotë nga të gjitha palët e interesuara, mjedisi për përfshirjen e shoqërisë civile në politikë bërje në Kosovë mund të bëhet edhe më i favorshëm.

Rekomandimet që po i cilësojmë e nxjerrim nga ky raport janë:

- Të zgjatet perioda e konsultimeve për dokumente më komplekse.
- Të promovohet më shumë platforma online për pjesëmarrje më të gjerë.
- Të forcohet komunikimi i dyanshëm për çdo koment të pranuar apo refuzuar.
- Të inkurajohet përfaqësimi i OSHC-ve lokale dhe atyre që nuk janë pjesë e rrjeteve ekzistuese.
- Digjitalizimi dhe përdorimi i mjeteve modern / Përdorimi i platformave digjitale për konsultim publik (si platforma për komente online, aplikacione për pjesëmarrje, etj.).
- Rrjetet sociale të jenë të bashkangjitura për këtë platformë.
- Mundësia që përgjegjësit e dokumenteve të jenë gati të komunikojnë për komentet dhe të vijnë me përgjigje për secilin koment që e marrim nga publiku dhe OJQ-të te platforma.

Këto rekomandime synojnë të sigurojnë përfshirjen e plotë të shoqërisë civile në procesin e konsultimeve publike, duke e bërë qeverinë të dëgjojë dhe të marrë parasysh kontributet dhe rekomandimet e tyre në hartimin e politikave dhe legjislacionit. Një përkushtim i tillë do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në vendimmarrjen publike, duke përmirësuar qeverisjen dhe drejtësinë për të gjithë qytetarët.

SHTOJCA I: Numri i përgjithshëm i projekt dokumenteve (Lista e dokumenteve të konsultuara gjatë vitit 2024)

SHTOJCA II: Lista e dokumenteve të publikuara sipas regjistrimit të platformës prej 01.01.2024-31.12.2024

	KONSULTAT	PLOTËSIMI STANDARDEVE I
I.	ZYRA E KRYEMINISTRIT	
	1. DRAFT Programi për Reforma në Ekonomi – Prioritetet e Reformave Strukturore 2024-2026	JO
	2. UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR. XX/2024 PËR PËRMBAJTJEN E PROCESVERBALIT TË INSPEKTIMIT	JO
	3. Programi Kombëtar për Integrim Evropian	PO
	4. PROJEKT RREGULLORE (QRK) NR. XX/2024 PËR STEMËN DHE VULËN E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM DHE ORGANEVE INSPEKTUESE SI DHE PËR DOKUMENTIN E IDENTIFIKIMIT TË INSPEKTORËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS	PO
	5. PROJEKT RREGULLORE (QRK) NR.xx/2023 PROCEDURAT E VERIFIKIMIT E SIGURISË SË PERSONELIT DHE PROCEDURËN E ANKESËS	PO
	6. PROJEKT RREGULLORE (QRK) NR XX/2023 PËR MBROTJEN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR NË FUSHËN INDUSTRIALE	PO
	7. PROJEKT RREGULLORE (QRK) NR XX/2023 PËR KLASIFIKIMIN, NDRYSHIMIN E STATUSIT TË KLASIFIKIMIT, ASGJËSIMIN DHE SHKATËRRIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR	PO
	8. PROJEKT RREGULLORE (QRK) NR XX/2023 PËR SIGURINË FIZIKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR	PO
	9. PROJEKT RREGULLORE (QRK) NR. XX/2023 PËR ADMINISTRIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR DHE THEMELIMIN E NJËSISË SË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR	PO
	10. STRATEGJIA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2024-2029	PO
	11. RREGULLORE (QRK) NR. XX /2024 PËR RREGULLAT E PËRBËRJES SË ORGANIT KOLEGJIAL NË PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË ANKESËS ADMINISTRATIVE NDAJ VENDIMIT PËRFUNDIMTAR TË INSPEKTIMIT	PO
	12. PLANI I VEPRIMIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE LGBTI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2024-2026	PO
	13. PROJEKT UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) NR.xx/2024 PËR STANDARDET E HARTIMIT TË LEGJISLACIONIT	JO
	14. PROJEKTLIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE TË VEÇANTA DHE HARMONIZIMIN E TYRE ME LIGJIN NR. 04/L -202 PËR SISTEMIMIN E LEJEVE DHE LICENCAVE	JO
	15. PROGRAMI PËR PARANDALIMIN DHE ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE 2025-2028	JO

	16. Draft Strategjia Shtetërore Kundër Korrupsionit 2024-2027 dhe Plani i Veprimit	JO
	17. Plani i veprimit 2025-2026 i rishikuar për zbatimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në republikën e Kosovës 2022-2026	PO
1.	MINISTRIA E ZHVILLIMIT RAJONAL	
	18. RREGULLORE (QRK) - NR. XX/2024 PËR MENAXHIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR	Po
	19. PROJEKT RREGULLORE (QRK) - NR. XX/2023 PËR THEMELIMIN, ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE MONITORIMIN E QENDRAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL NË RAJONET ZHVILLIMORE	PO
	20. PROJEKT RREGULLORE (QRK) - NR. XX/2024 PËR STANDARDET, METODOLOGJINË DHE SISTEMIN E HARTIMIT DHE MONITORIMIT TË PLANEVE OPERACIONALE PËR ZHVILLIM RAJONAL TË RAJONAVE ZHVILLIMORE	PO
	21. RREGULLORE (ZKM) NR.XX.2024 PËR PERFORMANCË RAJONALE DHE MONITORIM TË ZHVILLIMIT SOCIO - EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR	PO
	22. Draft-Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025 – 2027	PO
